

**#GEMEINSAM
ZUKUNFT
GESTALTEN**

Abstracts

zum Handlungskonzept gegen
Rechtsextremismus und Rassismus



Gefördert von



durch das Landesprogramm



Ministerium für
Kultur und Wissenschaft
des Landes Nordrhein-Westfalen



K Kommunales
Integrationszentrum
StädteRegion Aachen

Ekstremizmi i djathtë dhe racizmi vazhdojnë të rriten. Është ky një problem që do të donim të trajtonim në rajonin e qytetit Aachen (Städteregion Aachen). Ne duam të kuptojmë më mirë shkaqet dhe të zhvillojmë strategjitë se si duhet rritur vetëdijen rreth këtyre dukurive dhe të ndërmarrim veprime kundër tyre. Për këtë qëllim kemi zhvilluar një koncept veprimi kundër racizmit, antisemitizmit dhe ekstremizmit të djathtë.

Përgjegjëse për këto tema në rajonin e qytetit Aachen (StädteRegion Aachen) është Qendra Komunale për Integrim. Pra, nëse keni pyetje lidhur me këto tema ose keni diçka që nuk kuptoni, mos ngurroni të lajmëroheni atje.

Ne dëshirojmë t'ju informojmë se për çka bëhet fjalë në konceptin e veprimit dhe cilat synime ndjekim bashkë me partnerët tanë në regjion. Më poshtë gjeni një përmbledhje të shkurtër të secilit kapitull të planit të veprimit.

1. Hyrja dhe rekomandimet për veprime

Që nga viti 2017, StädteRegion Aachen përfshihet në projektin në nivel Landi NRWeltoffen. **Në këtë program të mbështetjes bëhet fjalë për punën kundër ekstremizmit të djathtë dhe racizmit.** Për këtë qëllim, Qendra Komunale e Integritimit harton koncepte veprimi duke u orientuar në nevojat konkrete në qytetet dhe komunat e rajonit të Aachen. Njerëzit e prekur mund kontribuojnë në hartimin e konceptit! Dëshirat dhe përvojat e tyre do të merren parasysh, ato do të analizohen dhe më pastaj të zhvillohen masa konkrete.

Për të zhvilluar rekomandimet aktuale për veprim kundër racizmit, kemi realizuar një anketë online. Ne pyetëm njerëzit nga Städteregion Aachen nëse dhe ku kanë përjetuar urrejtje, diskriminim ose racizëm në jetën e tyre të përditshme. Bëhej fjalë për fusha të ndryshme të jetës, për shembull puna, shkolla ose kontakti me administratën.

Një kapitull tjetër trajton ekstremizmin e organizuar të djathtë në rajon. Kjo temë është mbuluar me hulumtimet e një gazetari të fushës, me raportin e Zyrës për Mbrojtjen e Kushtetutës, raporteve të mediave dhe literaturës specialiste.

Tema e tretë e konceptit të veprimit është antisemitizmi. Në këtë kontekst është pyetur një ekspert i cili hulumton lidhur me antisemitizmin dhe i cili ka dhënë këshilla të rëndësishme mbi masat kundër antisemitizmit.

Objekti ynë: Të veprojmë të orientuar kah objektivat! Duam t'ju informojmë njerëzit, t'ju sqarojmë dhe të ndërhyjmë konkretisht në rast të paraqitjes së ekstremizmit të djathtë dhe racizmit. Po ashtu, duam t'ju trimërojmë njerëzit që jetojnë në rajonin e qytetit Aachen të veprojnë në mënyrë të njëjtë.

Disa nga objektivat e rekomandimeve për veprime janë:

1. **Ballafaqimi me racizmin dhe diskriminimin në institucionet arsimore:** Për çerdhet (Kitas) dhe shkollat ka informacione rreth racizmit dhe diskriminimit dhe si mund t'ju kundërvihemi këtyre dukurive. Ne u ofrojmë trajnime, përkrahje dhe përgjigje në pyetjet konkrete.

2. **Sensibilizimi i banorëve të regjionit rreth temave racizmi, antisemitizmi dhe diversiteti:** Për të ngritur vetëdijen e njerëzve që jetojnë këtu rreth këtyre temave, dhe për t'i informuar ata, ne organizojmë së bashku me partnerët tanë takime pune, javë të aksionit, fushata dhe shumë aktivitete tjera.
3. **Ofrimi i njohurive:** Ne ofrojmë seminare dhe informacione rreth temave si racizmi, antisemitizmi dhe ekstremizmi i djathtë.
4. **Nëse racizmi dhe diskriminimi shfaqen brenda autoriteteve,** ne do t'i paraqesim ato raste, t'i emërojmë ato dhe të ndërmarrim kundërmasa.
5. **Të vendosim sa më shumë në plan të parë diversitetin!** Ne shtyjmë përpara këto tema me partnerët tanë pranë administratës si dhe qyteteve dhe komunave.

Për të vepruar kundër ekstremizmit të djathtë dhe racizmit ne zhvillojmë së bashku masa konkrete dhe veprimet bashkërisht. Ne flasim rreth problemeve dhe sfidave si dhe zgjidhjeve të mundshme. Në këto procese i përfshijmë përvojat e njerëzve të prekur.

2. Objektivi i konceptit të veprimit & rrjetëzimi

Për t'u kundërvënë ekstremizmit të djathtë dhe racizmit, ne ndjekim dy strategji:

1. **Analizën nismëtare:** Ne përipiqemi të zbulojmë se ku janë problemet dhe sfidat. Ne kemi në fokus perspektivën e njerëzve që janë të prekur në mënyrë negative nga racizmi.
2. **Bazuar në këto analiza,** ne zhvillojmë masa të orientuara në objektiva dhe i zbatojmë ato.

Nëse duam të luftojmë me sukses ekstremizmin e djathtë, antisemitizmin dhe racizmin, të gjithë të përfshirët duhet ta kenë këtë si detyrë të përhershme. Këtu përfshihen, p.sh. politika dhe institucionet publike, institucionet arsimore, mediet dhe individët privatë. Është gjithashtu e rëndësishme të promovohet ngritja e qendrave të përshtatshme këshilluese.

NRWeltoffen në rajonin e qytetit Aachen do të ketë për synim edhe rrjetëzimin sa më të thjeshtë të të gjithë partnerëve të përfshirë. Duke vepruar si platformë rrjetëzimi, ne e shohim veten si partner qendror në rast të pyetjeve, vendosjes së kontakteve dhe ofrim të informacioneve. Partnerët e përfshirë përfshijnë politikën dhe autoritetet administrative, të gjithë sektorin e arsimit, vullnetarët dhe vullnetaret dhe sigurisht shoqërinë civile.

Është e rëndësishme të koordinohen ofertat, t'i vëni në pah shembujt e mirë dhe t'i koordinoni ato në formë qendrore. Në planin tonë të veprimit kemi treguar 16 shembuj nga rajoni i qytetit Aachen. Ata tregojnë se si iniciativat lokale, shoqatat, politika dhe administrata si dhe punëdhënësit mund të punojnë së bashku me partnerë të tjerë bashkëpunues. Në secilin shembull ne emërojmë grupet e synuara dhe temat në fokus.

3. Ekstremizmi i djathtë i formës së organizuar në rajonin e qytetit Aachen

Skena e ekstremizmit të djathtë në rajonin e qytetit Aachen është po aq jokonsistente siç është në gjithë Gjermaninë. Megjithatë ekziston në element i përbashkët: ekstremistët e djathtë duan të theksojnë se ekziston pabarazi në mes të njerëzve. Sipas mendimit të tyre, duke u nisur nga religjioni, origjina gjeografike (e parapërcaktuar) ose karakteristikat tjera të atribuara, njerëzit e

tjerë vlejnë më pak se „grupi i tyre“. Elementet thelbësore të ekstremizmit të djathtë përfshijnë racizmin, antisemitizmin dhe ndjenjën e tepruar të lidhjes me atdheun.

Skena e ekstremizmit të djathtë në rajonin e qytetit Aachen përbëhet pjesërisht nga anëtarë të skenës neo-naziste. Ata nuk shfaqen gjithmonë publikisht si ekstremistë të djathtë, por aktualisht shfaqen në ndërlidhje me protestat gjatë krizave të tilla si p.sh. pandemia e koronës ose lufta në Ukrainë dhe ajo në Izrael. Në këto grupe ekziston rreziku që ata t'i paraqesin botëkuptimet e tyre përtej çdo niveli të arsyeshem dhe për këtë shkak p.sh. të bëjnë thirrje për dhunë.

Përveç demonstratave dhe mitingjeve (p.sh. të ashtuq. demonstrata paqësore paqeje), përfaqësuesit e krahut të djathtë përdorin veçanërisht mediet digjitale si p.sh. grupet në Facebook ose shërbime informative të caktuara. Këtu ata përhapin përmbajtje të djathta ekstremiste si brenda ashtu edhe jashtë kufijve të rajonit të qytetit.

Në këtë mënyrë ata arrijnë kryesisht deri te adoleshentët dhe të rriturit (e rinj). Kjo mund të çojë në betonimin e qëndrimeve urrejtëse ndaj njerëzve dhe botëkuptimeve ideologjike konspirative. Është e rëndësishme që ndaj dukurive të tilla të vepohet me kundërstrategji dhe të edukojmë njerëzit për këtë. Fokusi është në një shoqëri gjithëpërfshirëse në të cilën barazia, diversiteti dhe kultura mikpritëse janë normaliteti i asaj shoqërie.

4. Hulumtimi: Përvojat me racizmin në rajonin e qytetit Aachen

Mendimet raciste pretendojnë se njerëzit me karakteristika të caktuara, si p.sh. njerëzit me lëkurë të bardhë janë më të mirë se të tjerët dhe për këtë arsye disa padrejtësi të caktuara merren si diçka normale. Dallimet, të cilat zakonisht lidhen me pamjen, gjuhën, origjinën ose religjionin, mund të pasqyrohen në paragjykimet e këtyre grupeve. Diçka e tillë nuk ka të bëjë më me persona individual. Në këtë mënyrë konstruktohen grupe të cilave u atribuohen disa karakteristika (zakonisht negative) pa hyrë në diskutime të thella.

Shkenca dallon tri forma të racizmit:

Racizmi institucional: Në disa vende, të parapara faktikisht për të gjithë njerëzit, si p.sh. shkollat, autoritetet, universitetet, personat me ngjyrë të bardhë e kanë më të lehtë se grupet tjera. Diçka e tillë nuk guxon të ndodhë sepse në kushtetutën tonë thuhet se të gjithë njerëzit janë të barabartë dhe duhet të kenë edhe shanset e njëjta.

Racizmi individual: Me racizmin individual nënkuptohet ajo formë e racizmit e cila paraqitet ndërmjet personave të veçantë ose ndërmjet më shumë personave. Racizmi individual nënkupton ofendimin racist të një personi nga ana e personit tjetër ose rastet kur atij i jepet ndjenja se për shkak të dukjes ose të origjinës ai është i ndryshëm nga të tjerët.

Racizmi strukturor: Për ndryshim nga racizmi individual, te racizmi strukturor nuk kemi të bëjmë me ndonjë bisedë të veçantë gjatë së cilës flitet diçka raciste ose shfaqet ndonjë ofendim. Përkundrazi, racizmi strukturor ka të bëjë me faktin se jo të gjithë njerëzit gëzojnë të njëjtat parakushte bazë në një shoqëri, sepse shumë procese dhe rregulla në shoqëri favorizojnë njerëzit e bardhë. Kjo vë në fakt se shumë shtete në botë janë shtypur nga kolonializimi i njerëzve të bardhë. Kjo ende ka ndikim në jetën e shumë njerëzve.

Kjo mund të bëhet në formë të hapur ose subtile, pra në atë mënyrë që nuk vihet re në shikim të parë.

Për të krijuar një bazament për planin e veprimit, ne kemi pyetur mbi përvojat e tyre me racizmin njerëzit me biografi personale ose familjare migracioni. 70 për qind e të anketuarve kanë thënë se kishin përjetuar racizëm në jetën e tyre.

Kapitulli mbi racizmin përmban informacione të detajuara lidhur me metodikën dhe temat kryesore të hulumtimit të opinionit. Këtu bëjnë pjesë përvojat personale me racizmin, vlerësimi i shkaqeve të racizmit, përvojat me autoritetet dhe institucionet si dhe detyrat për veprime konkrete që i kemi dhënë rajonit të qytetit Aachen.

5. Antisemitizmi - bazat dhe rekomandimet për veprime

Antisemitizmi nuk është një formë e re, por një formë shekullore e urrejtjes ndër-njerëzore e orientuar kundër njerëzve që emërohen si „hebrej“. Antisemitizmi nuk ishte pjesë e hulumtimit të opinionit. Megjithatë, kjo temë është e rëndësishme dhe në kuadër të këtij kapitulli përfshihet në rekomandimet për veprime për rajonin e qytetit Aachen. Krahas sqarimit të detajuar të terminologjisë, tregohen edhe forma të ndryshme të antisemitizmit. Për shembull, kjo mund të nënkuptojë se njerëzit nuk duan që hebrejtë të banojnë në shtetin e tyre, pastaj që pa ndonjë shtjellim të mëtejme, hebrejtë të supozohen se paraqesin rrezik ose dukuria tjetër mjaft e shpeshtë në skenën djathtiste e njohur si “antisemitizëm i shfajësuar”. Kjo e fundit do të thotë kur njerëzit thonë se tanimë nuk kemi nevojë të ballafaqohemi edhe më tej me të kaluarën nacional-socialiste të Gjermanisë. Por, ne e dimë se kjo është më se e domosdoshme për të qenë në gjendje të njohim dhe të luftojmë antisemitizmin edhe në të ardhmen.

Për këtë kapitull kemi përdorur ekspertizën e Qendrës për Kërkime mbi Antisemitizmin dhe Racizmin (CARS). Kjo qendër ndodhet në Universitetin Katolik NRW (Departamenti Aachen). Nga atje kemi marrë rekomandimin për të bërë hulumtime të opinionit mbi temën e antisemitizmit në rajon me qëllim që të përcaktohen nevojat specifike nga këndvështrimi i hebrejve. Përveç kësaj, këta njerëz duhet të përfshihen në hartimin e kundërmasave përkatëse. Sqarimet, kritikrat dhe edukimi mund të ndihmojnë në veprimet kundër antisemitizmit.

6. Përfundim

Është shumë e rëndësishme të merren seriozisht problemet e shkaktuara nga racizmi dhe ekstremizmi i djathtë. Të gjithë duhet të punojnë së bashku për të siguruar paqen sociale dhe bashkëjetesën e mirëqenë në rajonin tonë, sepse qëndrimet ekstremiste dhe nacionaliste rrezikojnë paqen në mbarë botën.

Ne në rajonin e qytetit të Aachen kemi përgjegjësinë të ngrihemi kundër urrejtjes dhe diskriminimit si në mjediset tona personale ashtu edhe në ato publike.

Herausgeberin

StädteRegion Aachen
Der Städteregionsrat
A 46 | Kommunales Intergrationszentrum
Trierer Straße 1
52078 Aachen

Telefon + 49 241 5198 0
E-Mail info@staedteregion-aachen.de
Internet staedteregion-aachen.de

Verantwortlich
Redaktion/Text
Gestaltung/Druck
ckerei
Bezeichnung

Verena Mohnen
Verena Mohnen
StädteRegion Aachen, Dru-
ckerei
A46/Handlungskonzept/
Abstracts 02.24

Stand

Februar 2024

StädteRegion Aachen

Der Städteregionsrat
Postanschrift
StädteRegion Aachen
52090 Aachen

Telefon + 49 241 5198 0
E-Mail info@staedteregion-aachen.de
Internet staedteregion-aachen.de

Mehr von uns auf

